



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 118 Prot

Tiranë, më 30, 08, 2013

**VENDIM QARKULLUES Nr. 269, datë 30, 08, 2013**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi "Raportin përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Sheshin e ndërtimit me adresë: "Lagjja Nr.7, Rruga " I. Buzhiqi", zona arkeologjike B, Durrës mbi bazën e kërkesës së Subjektit "VNdërtim (Badriklo)" sh.p.k., Durrës,

**VENDOSI:**

- I. Miratimin e raportit përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës për Sheshin e ndërtimit të Subjektit "VNdërtim (Badriklo)" sh.p.k., Durrës.
- II. Të lejojë fillimin e punimeve në sheshin e ndërtimit "Godinë banimi dhe shërbimi 5-7-9-10 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë", zona arkeologjike "B", Durrës, të Subjektit "VNdërtim (Badriklo)" sh.p.k.
- III. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike deri në përfundim të procesit të gërmimit të themeleve, bazuar në kontratën dypalëshe midis "VNdërtim (Badriklo)" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.  
Mbikëqyrja arkeologjike do të kryhet nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës deri në arritjen e kuotës së gërmimit të parashikuar në projekt.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**VISAR ZHITI  
MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA  
ROLAND OLLI**

